



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr.499 Vendimi**

**Tiranë, më 13.01.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Alma Faskaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Suela Zhegu</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 05.01.2022, mori në shqyrtim në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Alvano Murataj**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germa “a”, e pikës 1, të nenit 64;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Alvano Murataj ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Komisioni ra në dijeni të faktit se subjekti i rivlerësimit Alvano Murataj ka ndërruar jetë. Lidhur me këtë fakt, Komisioni iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2021, për certifikatën e vdekjes së z. Alvano Murataj, e cila me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 3.11.2021 informon dhe përcjell certifikatën e vdekjes së z. Alvano Murataj, nga ku konstatohet se ka ndërruar jetë në datën 19.11.2017.
3. Komisioni iu drejtua me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2021, Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të së cilës i kërkoi informacion nëse nga ky institucion ka vendimmarrje lidhur me përfundimin e statusit të magjistratit Alvano Murataj. Këshilli i Lartë Gjyqësor informon me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, se nga ky institucion nuk ka vendimmarrje lidhur me përfundimin e statusit të z. Alvano Murataj.

#### **ARSYETIMI I KOMISIONIT**

5. Subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
6. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Alvano Murataj, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligjit, ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:
  - a. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
7. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit, në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 44/20151 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë neni 90, ku parashikohet: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohe dhe përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij kodi*” dhe të nenit 93, ku parashikohet: “*Nëse pala, personi fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal,*

*organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen”.*

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenet 90 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për subjektin Alvano Murataj.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.01.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Relatore**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*